

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË " ARCH I.D.E ATELIE " SH.P.K.**

Sot, me datë 13/02/2023,

**Z. Eduard Gaba**, shtetas Austriak, lindur më 08/08/1967 në Tirane, Shqiperi, mbajtës Pashaportes me nr.U6014681 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **ARCH I.D.E ATELIE**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### **NENI 1**

##### **EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është " **ARCH I.D.E ATELIE** " Sh.p.k.

#### **NENI 2**

##### **SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, ndertesa nr.31, hyrja nr.2, kodi postar 1023.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### **NENI 3**

##### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

#### **NENI 4**

##### **OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Projektim objekte civile – industrial.*

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2.000.000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Eduard Gaba** zoteron 1 kuotë, me 100 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.000.000 Lek dhe 2.000.000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Enkelejd Saliaj, shtetas shqiptar, lindur më 15/08/1977 në Fier, Shqiperi, mbajtës i kartes se ID me nr : 033957985 dhe nr ID: H70815070B , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar**, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe .

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z.** \_\_\_\_\_, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. \_\_\_\_\_, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

*Z.Eduard Gaba*

